



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I BASHKISË SKRAPAR

VENDIM

Nr. 05, datë 22.01.2021

PËR DHËNIEN E TITULLIT “QYTETAR NDERI” I SKRAPARIT

Z. XHAFER IBRO

Këshilli Bashkiak Skrapar, në mbledhjen e datës 22.01.2021, mori në shqyrtim propozimin e Kryetarit të Bashkisë, Z. Adriatik Mema, mbështetur në Ligjin Nr.139/2015, “Për Vetëqeverisjen Vendore” i ndryshuar, Ligjin Nr. 112/2013 “Për dekoratat, titujt e nderit, medaljet dhe titujt vendorë të nderit në Republikën e Shqipërisë”, neni 14, 15 pika 1, gërma “a”, pika 2, gërma “b”, neni 16 dhe vijues,

VENDOSI:

1. Dhënie e titullit “Qytetar Nderi” i Skraparit, Z. Xhafer Ibro (pas vdekjes), me motivacionin:

“Në vlerësim të lartë të kontributit të tij të shquar në fushën e pedagogjisë dhe mësimdhënies, dimensionit të shquar profesional, qytetar, human dhe modern që promovoi gjatë gjithë karrierës së tij. Intelktual i spikatur që gjeneroi mirësi, kulturë dhe civilizim, duke u shndërruar në një model të vërtetë për brezat e rinj dhe bashkëkohësit e tij”.

2. Për zbatimin e këtij Vendimi ngarkohet Kryetari i Bashkisë Skrapar.

3. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Vendimi u miratua me 14 vota pro, vota kundër – s’ka, vota abstenim – s’ka.

Për konfirmim Prefektit të Qarkut.

KRYETARE KËSHILLIT BASHKIAK

Edlira SHKËMBI

